



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURENCËS-
KOMISIONI I KONKURENCËS

V E N D I M

nr. 408 , datë 21.03.2016

Për

“Disa rekomandime për Entin Rregullator të Energjisë mbi draft metodologjinë e tarifës fikse të energjisë elektrike të prodhuar nga burime të rinovueshme”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- | | |
|----------------------------|------------|
| ▪ Znj. Lindita Milo (Lati) | Kryetar |
| ▪ Znj. Servete Gruda | Zv/Kryetar |
| ▪ Z. Koço Broka | Anëtar |
| ▪ Znj. Iva Zajmi | Anëtar |
| ▪ Z. Eduart Ypi | Anëtar; |

Në mbledhjen e tij të datës 21.03.2016, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Shqyrtimi i vleresimit të draft metodologjisë së tarifës fikse të energjisë elektrike të prodhuar nga burime të rinovueshme.

Baza Ligjore: Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar), neni 24 pika d) dhe f), neni 69 dhe neni 70.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të vleresimit në lidhje me draft metodologjinë e tarifës fikse të energjisë elektrike të prodhuar nga burime të rinovueshme të publikuar në faqen zyrtare të ERE-s:

V Ë R E N S E:

Autoriteti i Konkurrencës është shprehur më parë në lidhje me Projektligjin “Për burimet e energjisë së rinovueshme”, dhe me anë të shkresës nr.514/1, datë 19.12.2011 theksohet se “përcaktimi i nenit 17, mund të sjellë kufizime të konkurrencës efektive në këtë segment tregu¹”, duke sugjeruar që të përcaktohen “...tarifat e transmetimit dhe të shpërndarjes të jenë jo-diskriminuese për prodhuesit dhe përfituesit e energjisë së rinovueshme...”

Gjithashtu bazuar në direktivën 2009/28/EC, nuk përcaktohen kontrata afatgjata apo

¹ Referuar nenit 17 të projektligjit të ardhur për mendim

tarifa fikse të shitjes si instrumente nxitëse të prodhimit të energjisë së rinovueshme.

Direktiva përcakton që shtetet anëtare të BE-së duhet të krijojnë politika nxitëse për prodhuesit e energjisë së rinovueshme, nëpërmjet sistemit të taksave, mundësive apo kapaciteteve të mjaftueshme të transmetimit me qëllim që prodhuesit të kenë kosto të ulëta prodhimi dhe shitje të larta të energjisë së prodhuar nga burimet e rinovueshme, duke mos patur diskriminime për shkak të vendndodhjes apo të sasisë së ulët të energjisë që nevojitet për një komunitet të caktuar apo disi të izoluar.

Në këndveshtrim të konkurrencës nëse operatorët e tregut do të prodhojnë energji të rinovueshme dhe nuk do të konkurrojnë në treg të lirë, por do të operojnë duke shitur nëpërmjet kontratave 15 vjeçare me çmime fikse, atëherë potencialisht konkurrenca në tregun përkatës kufizohet, pasi kontratat afatgjata dhe me çmime fikse shkaktojnë kufizim dhe pengim të konkurrencës, si rrjedhim edhe të përfituesve që në këtë rast janë konsumatorët e energjisë elektrike.

PËR KËTO ARSYE

Në zbatim të nenit 24, shkronja (d) dhe (f) dhe nenit 70 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar), Komisioni i Konkurrencës,

V E N D O S I :

I- T’i rekomandojë Enti Rregullator të Energjisë të heqë nga draftmetodologjia afatin 15 vjeçar të kontratave si edhe çmimet fikse të shitjes së energjisë së rinovueshme.

II- Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete Gruda
(_____)

Zv.Kryetar

Koço Broka
(_____)

Anëtar

Iva Zajmi
(_____)

Anëtar

Eduard YPI
(_____)

Anëtar

Lindita MILO (LATI)

K R Y E T A R